

NË EMËR TË POPOULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, përmes gjyqtares së vetme gjykuese Snezhana Mihajllloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të pandehurit E.A. nga fsh. ..., kom ..., me mbrojtësin e tij av. B.D. nga ..., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378. paragr.6 lidhur me paragr. 1 KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.400/2018 të datës 23.03.2018, të cilën e përfaqëson prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së seancës fillestare orale e publike lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë të lidhur në prokurori më dt.29.03.2018, më dt.29.05.2018 në prezencë të palëve publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

I pandehuri **E.A.** nga babai I. dhe nëna E. – I., i lindur më dt. ... në ..., jeton në fsh. ..., nxënës i gjimnazit, i martuar, pa fëmijë, i gendjes së mesme ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

Ë S H T Ë F A J T O R

sepse më dt. 07.03.2018 rreth orës 19:45 minuta në rrugën lokale ...-... derisa i pandehuri ishte duke drejtuar automjetin e markës “ ... ” me tabela të regj. ... ka rrezikuar trafikun publik duke vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që duke bërë tejkalim të pasigurt, pa u bindur se me këtë veprim mund t'i rrezikoj pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, e në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 71 të Ligjit mbi Sigurinë e Komunikacionit rrugor, me të arritur në hyrje të fsh. ..., më saktësisht afër shtëpisë së A.Rr. me pasqyrën e majtë e godet këmbësorin – të dëmtuarin I.Xh. i cili ishte duke lëvizur përkaj rrugës në anën e majtë në drejtim të qendrës së ..., duke i shkaktuar lëndime trupore, i cili për shkak të lëndimeve të pësuarra ka qenë i detyruar të kërkoj ndihmën mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjilan, raporti mjekësor nr. ... i dt. 07.03.2018

- me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378. paragr.6 lidhur 1 të KPRK.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4,7,17, 23,40,41,42,46,73 dhe 74 KPRK si dhe nenit 247,365,451,463 KPPK të pandehurit i shqipton

DËNIMIN ME GJOBË

I. Të pandehurit i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 250 (dyqindpesëdhjetë)€ të cilin dënim ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë do të revokohet dhe do t'i zëvendësohet me dënim burgu, ashtu për një ditë burgu do të llogariten 20 €.

II. I dëmtuari I.Xh., për realizimin e kërkesës pronëso- juridike është udhëzuar në kontestin civil.

III. I akuzuari obligohet që në bazë të nenit 39 paragr.3 nënparagr.3.1 të Ligjit mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit, në emër të taksës për kompensim, të paguaj shumën prej 30 €.

IV. I pandehuri obligohet që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 25 € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, në afat prej 15 ditësh.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritë aktakuzën PP.nr. 400/2018 të dt. 23.03.2018 kundër të pandehurit E.A. nga fsh. ..., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378. paragr.6 lidhur me paragr. 1 KPRK, duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Prokurorja e Prokurorisë Themelore në Gjilan Bahtije Ademi në seancën e caktuar lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal të mbajtur më dt.29.03.2018, mbeti pranë marrëveshjes së arritur mbi pranimin e fajësisë të lidhur konform ligjit dhe dispozitave të nenit 233 KPPRK, me ç'rast i pandehuri është njoftuar për pasojat dhe natyrën e nënshkrimit të pranimit të fajësisë dhe mbetet pranë qëndrimit se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që gjykata në tërësi të aprovoj marrëveshjen e përmendur.

Mbrojtësi i të akzuarit av.B.D. dhe i akuzuari E.A. në tërësi janë pajtuar me propozimin e prokurorit të shtetit që propozimi të aprovohet, se gjatë arritjes së marrëveshjes i akuzuari ishte i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë, është pajtuar me këtë dhe garanton se në të ardhmen nuk do të ndeshet me ligjin sepse sinqerisht e ka pranuar fajësinë. I akuzuari pendohet për veprën e kryer, deri sot nuk ka qenë i gjykuar, andaj, lutë gjykatën që të ketë parasysh këtë fakt, sepse edhe me këtë dënim ka për tu arritur qëllimi i ndëshkimit.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë i përmban të gjitha faktet, propozimin për arritje të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, njoftimi i të akzuarit me të drejtat e tij dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhënia e deklaratës me shkrim, se i njëjti ka pranuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se të gjitha këto i ka pranuar me vullnetin e tij të lirë.

Gjykata gjen se i akuzuari ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe të sanksionit penal konform nenit 233 KPPRK dhesë e njëjta marrëveshje është në harmoni me kushtet e parapara me nenin pikën 12 të këtij neni.

Gjykata vërtetoi se i akuzuari ka kryer veprën penale dhe konstatoi se nuk ekziston asnjë rrethanë për përjashtim e paraparë me nenin 248 KPPRK.

Gjykata aprovoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë të lidhur në mes të PTH-Departamentit të Përgjithshëm nga njëra anë, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij nga ana tjetër për kryerjen e veprës penale të cekur në aktakuzën PP.nr. 400/2018 të dt.23.03.2018, pasi që për këtë janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore.

Gjykatësja e vetme gjykuese vlerësoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e të pandehurit, pas konsultimit të njaftueshëm me mbrojtësen e tij, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar në asnjë mënyrë të pranoj fajësinë. Pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet e cekura në aktakuzë dhe nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 253.paragr.1 KPPRK.

Gjykata është e bindur se shqiptimi i dënimit me gjobë është në harmoni me peshën e kryerjes së veprës penale dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41. KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është bazuar në nenin 451 KPPRK ndërsa vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike është marr në bazë të nenit 463 KPPRK.

Në bazë të cekurave të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.294/2018 më dt. 29.05.2018

Sekretarja juridike,
Suzana Kovaçević

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Snezhana Mihajloviq

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.

Përktheu –
Naile Keçmezi

